

Rregullat e Fushatës “Fast Track International”
Përkuftimi dhe interpretimi i tyre

FastTrack (apo Kalimi i shpejtë) nënkuption shërbimin e veçantë që i lejon një personi të kalojë të gjitha formalitetet në aeroport në kohën më të shkurtër dhe rehatinë më të lartë, pa radhë të gjata .

Kodi QR nënkupton një kod të veçantë grafik përmarrjen e Shërbimit, që i jepet Anëtarit të Fushatës në Chatbot, në përputhje me kushtet e këtyre Rregullave.

Aeroporti do të thotë Aeroporti i Stambollit (IST), Turqi; Aeroporti Ndërkombëtar i Larnakës (LCA), Republika e Qipros; Milano (MXP) Itali; Aeroporti i Barcelonës (BCN), Spanja dhe aeroporte të tjera, lista gjithëpërfshirëse e të cilëve është në dispozicion në chatbot.

Fushata nënkupton reklamën promocionale “FastTrack International”.

Banka nënkupton një person juridik i cili, bazuar në licencën përkatëse bankare, ka të drejtën ekskluzive të ofrimit të shërbimeve bankare në territorin e Ukrainës, Gjeorgjisë apo të Republikës së Azerbajxhanit,

Republikës së Bjellorusisë, Republikës së Taxhikistanit, Republikës së Uzbekistanit, Republikës së Armenisë, Republikës së Kazakistanit, Republikës së Moldavisë, Republikës së Kirkiztanit, Republikës së Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Republikës së Kosovës, Republikës së Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi ose Republikës së Serbisë.

Pajisja e verifikimit nënkupton një pajisje t teknike të posaçme në Aeroport që mundëson leximin e kodit QR përmes t'i ofruar Shërbimin Anëtarit të Fushatës , sipas kushteve të këtyre Rregullave.

Klienti nënkupton Asociacionin e Shërbimit Ndërkombëtar Visa, me vendndodhje në SHBA, CA 94404 – 2775, Foster City, Metro Center Boulevard, 900.

Kartelat nënkuptojnë kartat e pagesave Visa Platinum, Visa Signature, Visa Platinum Business, Visa Signature Business dhe Visa Infinite, të lëshuara nga Banka që i jep të drejtën Anëtarit të Fushatës të marrë pjesë në Fushatë.

Messenger nënkupton aplikacionin celular për dërgesën e mesazheve dhe videoove, përfshirë Viber, Telegram.

Organizatori nënkupton INFOCUS, LLC, kodi identifikues i personit juridik: 36563986, me vendndodhje në Ukrainë, 03150, Kiev, rruga Dilova 2, shkronja B, dhoma 188, shkronja A..

Partner nënkupton RENOVATIO, LLC, kodi i identifikimit të personit juridik: 38876589, me vendndodhje në Ukrainë, 61099, Kharkiv, rruga Yenakiivska, 11-A.

Shërbimi nënkupton shërbimet në kategorinë FastTrack (në mbërritje dhe nisje), që u ofrohen Anëtarëve të Fushatës në Aeroport. Ky shërbim është dhuratë për Pjesëmarrësin në Promovim.

Rregullat nënkuptojnë rregullat e Fushatës.

Afati i vlefshmërisë nënkupton periudhën nga ora 00:00:01 të datës 09.07.2021 deri në ora 23:59:59 të datës 30.09.2024.

Anëtarë të Fushatës nënkupton individët, Mbajtësit e kartave, që kanë të drejtë të marrin pjesë në Fushatë sipas dispozitave të këtyre Rregullave. Shërbimi është i njëjtë përmë të gjithë Pjesëmarrësit. Në këtë rast, ndryshimi i vetëm është se cilat karta kanë mbajtësit e tyre..

Chatbot nënkupton chatbot-in “Visa Consierge”, që gjendet në vegëzën https://mssg.me/concierge_service, që gjendet në Messenger.

1. Procedurae Pjesëmarrj në Fushatë për Anëtarët e Fushatës

1.1. Për qëllime të pjesëmarrjes në Fushatë, personi që dëshiron të marrë pjesë në Fushatë dhe të bëhet Anëtarë i Fushatës do t'i kryejë veprimet vijuese brenda Afatit të Vlefshmërisë së Fushatës:

- 1.1.1.** të jetë mbajtës i kartës së vleshme;
- 1.1.2.** ta regjistrohet vetë ose të regjistrohet në Chatbot sipas mekanizmave të brendshëm të Chatbot-it;
- 1.1.3.** hapnichatbot-in, shkoni te menyja “Visa Travel” dhe klikoni në “Fast Track International”;
- 1.1.4.** të njoftoheni me të dhënrat rreth Fushatës dhe këto Rregulla duke e klikuar butonin “FastTrack International”;
- 1.1.5.** kontrolloni disponueshmërinë e shërbimit dhe zgjidhni vendin dhe aeroportin ;
- 1.1.6.** tklikoni në butonin “merr kuponin”;
- 1.1.7.** zgjedhni njërin nga llojet e fluturimeve: Nisje brenda, Nisje Ndërkombëtare dhe Mbërritje Ndërkombëtare;
- 1.1.8.** ta shënojë numrin, datën, orën e nisjes së fluturimit, emrin dhe mbiemrin (sipas biletës), numrin e telefonit dhe e-mail adresën, në Chatbot.

1.2. Në rast të kryerjes së suksesshme të veprimeve nën pikat 1.1.1.-1.1.8. të këtyre Rregullave, personi do të bëhet Anëtar i Fushatës dhe do ta pranojë një dokument me kodin QR në Chatbot.

1.3. Këto Rregulla do të janë dokumenti kryesor në marrëdhëni zyrtare në mes Anëtarit të Fushatës dhe Organizatorit/Klientit/Partnerit. Anëtar i Fushatës do të pranoj dispozitat e këtyre Rregullave duke i kryer me sukses veprimet e cekura në pikat 1.1.1.-1.1.8. të këtyre Rregullave.

1.4. Pranimi nga Anëtar i Fushatës do të bëhet në mënyrë vullnetare dhe përfshijë marrëveshje të shkruar mbi kushtet e këtyre Rregullave.

1.5. Pranimi i pjesshëm i këtyre Rregullave nuk do të pranohet.

1.6. Karta do të jetë e vlefshme gjatë tërë afatit të vlefshmërisë së biletës së fluturimit.

2. Veçoritë e aplikimit të kodit QR

2.1. Ju mund të porosisni shërbimin në çdo datë të vitit. Kodi QR është i vlefshëm në datën e porositjes së shërbimit, por vlen për fluturimin e cekur në pikat 1.1.7. dhe 1.1.8. të Rregullave.

2.2. Kodi QR do t'u jepet Anëtarëve të Fushatës në Kampanjë, sipas kufizimeve të mëposhtme:

- 2.2.1.** për Anëtarët e Fushatës së Mbajtësve të Kartave Visa Platinum, do të sigurohen jo më shumë se 2 (dy) kode QR brenda Afatit të Vlefshmërisë së Fushatës;
- 2.2.2.** për Anëtarët e Fushatës së Mbajtësve të Kartave Visa Signature, do të sigurohen jo më shumë se 10 (dhjetë) kode QR brenda Afatit të Vlefshmërisë së Fushatës;
- 2.2.3.** për Anëtarët e Fushatës së Mbajtësve të Kartave Visa Infinite, do të sigurohet sasia e kërkuar e kodeve QR nga Anëtarët e Fushatës Mbajtës të Kartelave Visa Infinite brenda Afatit të Vlefshmërisë së Fushatës.

2.3. Kodi QR mund të përdoret ekskluzivisht nga Anëtar i Fushatës vetëm për nevoja të veta dhe nuk mund t'u bartet palëve të treta.

2.4. Kodi QR i papërdorur brenda Afatit të Vlefshmërisë së Fushatës nuk do të mund të vlejë në një afat të mëvonshëm apo të ruhet, nuk do të mund të shtohet apo t'i nënshtrohet ndonjë kompensimi financier apo çfarëdo lloji tjetër kompensimi.

2.5. Dokumenti i kodit QR ka funksionin e “butonit të përgjigjes së shpejtë” për të rënë në kontakt me përkrahjen teknike të Partnerit, në rast të ndonjë problemi me kodin QR.

3. Përgjegjësitë e palëve

3.1. Anëtari i Fushatës do të jenë përgjegjës, sipas legjisacionit në fuqi, për saktësinë e të dhënavë të ofruara dhe të drejtën e përdorimit të Kartës.

3.2. Pagesa e tatimeve, tarifave dhe pagesave të detyrueshme do të kryhet nga personi të cilit i ngarkohen detyrimet përkatëse sipas dispozitave të legjisacionit në fuqi.

3.3. Klienti/Partneri/Organizatori nuk do të jetë përgjegjës për pamundësinë e Anëtarit të Fushatës për ta përdorur Kodin QR për shkaqe që janë jashtë kontrollit të tyre, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, prishjen e Pajisjes Verifikuese, anulimin, shtyrjen apo vonesën e fluturimit, ndryshimin e funksionimit të Aeroportit, shkeljen e dispozitave të legjisacionit në fuqi nga ana e Anëtarit të Fushatës, etj.

4. Përpunimi i të dhënavë personale

4.1. Në kuadër të Fushatës, Anëtari i Fushatës do t’ia ofrojë Organizatorit të dhënat vijuese personale, në përputhje me marrëveshjen e arritur në kuadër të këtyre Rregullave e që është arsyé individuale për përpunimin e të dhënavë të tij/saj: mbiemri, emri, patronimi në anglisht, numri i telefonit dhe e-mail adresa. Këto rregulla të përpunimit të të dhënavë do të jenë pjesë e rregullave të përpunimit të të dhënavë të përfshira në Chatbot.

4.2. Të dhënat personale të cekura në pikën 4.1. do të përpunojnë përgjatë Afatit të Vlefshmërisë së Fushatës, në mënyrë që Anëtari i Fushatës të marrë pjesë në Fushatë. Këto të dhëna personale do të mblidhen, përpunohen, barten (te serverët e jashtëm të Organizatorit dhe Partnerit) për qëllimet e përbushjes së kushteve të këtyre Rregullave. Organizatori do të jetë pronari dhe administratori i këtyre të dhënavë personale. Partneri do t’i ketë politikat e veta të trajtimit të të dhënavë personale, por në cilindo rast, këto të dhëna nuk mund të përpunojnë në kundërshtim me këto Rregulla. Anëtari i Fushatës mund të njoftohet me Politikat e Partnerit për Përpunimin e të Dhënavë Personale duke e vizituar këtë adresë interneti: <https://highpass.aero/Home/PrivacyPolicy>.

4.3. Derisa kryen veprimet e cekura në pikën 1.1. të Rregullave, Anëtari i Fushatës pajtohet me mënyrën e përpunimit të të dhënavë të tij personale dhe, përvèç kësaj, do ta konfirmojë se është i njoftuar me të gjitha të drejtat që i janë dhënë sipas legjisacionit në fuqi.

5. Të ndryshme

5.1. Organizatori ka të drejtë të përfshijë palët e treta për të përbushur detyrimet sipas Rregullave të Fushatës .

5.2. Në rast të paraqitjes së ndonjë situate që krijon paqartësi në interpretimin e këtyre Rregullave, çfarëdo kontesti dhe/apo çështjeje që nuk rregullohet nga këto Rregulla, Organizatori/Klienti i Fushatës rezervon të drejtën t’i zgjidhë çështjet në fjalë në mënyrë të pavarur. Ky vendim i Organizatorit/Klientit të Fushatës do të jetë përfundimtar dhe nuk mund t’i nënshtrohet ankesës.

5.3. Afati i Vlefshmërisë së Fushatës mund të ndryshohet apo Fushata mund të përfundojë para kohe si rezultat i pajtimit të dyanshëm në mes Klientit dhe Organizatorit. Ndryshimi i Afatit të Vlefshmërisë së Fushatës apo përfundimi i parakohshëm vlen vetëm në rast të publikimit në Chatbot.

5.4. Këto Rregulla dhe ndryshimet e tyre do të publikohen si referencë në Chatbot.

5.5. Organizatori rezervon të drejtën t'i ndryshojë Rregullat e tanishme brenda Afabit të Vlefshmërisë së Fushatës.